

UDHËZIM
Nr. 22, datë 30.7.2018

**PËR PROCEDURAT STANDARDE TË MONITORIMIT TË BUXHETIT TË NJËSIVE
TË VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 48, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe afateve që duhet të ndjekin njësitë e vetëqeverisjes vendore për monitorimin e zbatimit të buxhetit për performancën financiare, për produktet dhe objektivat e politikës të realizuar për çdo program gjatë një viti buxhetor.

2. Ky është një udhëzim i përhershëm (standard), në të cilin përcaktohen: roli, përgjegjësitë dhe detyrat e grupit të menaxhimit strategjik (GMS), procedurat që duhet të ndjekin Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP), për monitorimin e zbatimit të buxhetit vjetor, me qëllim realizimin e objektivave të synuar, të produkteve të parashikuara, si dhe për përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

3. Në këtë udhëzim përcaktohen:

- Roli i kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Roli i Këshillit të Njësisë së Vetëqeverisjes vendore;
- Roli i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Afatet e paraqitjes së raporteve të monitorimit në Këshillin e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe publikimi i raporteve;
- Struktura dhe përmbajtja e raporteve të monitorimit.

4. Monitorimi, është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar. Monitorimi ka për qëllim:

4.1 Të ndjekë arritjen e qëllimit dhe objektivave të përcaktuar në deklaratën e politikës së programit për vitin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm, nëpërmjet krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me rezultatet faktike të tyre.

4.2 Të sigurojë informacion i cili i shërben përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit të zbatimit të buxhetit.

4.3 Të evidentojë, nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, dhe nëse jo të propozojë/rekomandojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese për rishpërndarjen e fondeve. Në rast rishpërndarje të fondeve buxhetore, të evidentojë efektin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhur me ta.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të menaxhojnë shpenzimet në mënyrë të tillë që të realizohen produktet e parashikuara, brenda limitit të miratuar të shpenzimeve të programit dhe të sigurojnë informacion në lidhje me performancën e shpenzimeve dhe realizimin e produkteve.

6. Monitorimi i objektivave kryhet bazuar në treguesit përkatës të performancës që jepen kryesisht në nivel produkti, ndërsa monitorimi i produkteve realizohet në sasi dhe në vlerë. Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

II. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E MONITORIMIT TË BUXHETIT

7. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë monitorimin e performancës së tyre dhe institucioneve në varësi.

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore monitorojnë zbatimin e planeve strategjike të zhvillimit, nëpërmjet monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor.

Përgjegjësia e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

9. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes është kryetar i Grupit për Menaxhimin Strategjik dhe si rregull është nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ai mund ta delegojë këtë kompetencë, me shkrim, te zëvendëskryetari ose te një nga zëvendëskryetarët e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

10. Kryetari miraton rregullat specifike dhe procedurat që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi, si dhe udhëzimeve plotësuese të tij.

11. Kryetari vlerëson raportet e monitorimit për të gjitha programet buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes,

të përgatitura dhe të konfirmuara nga GMS-ja dhe të nënshkruara nga koordinatori i GMS-së. Për çdo rast të konstatimit të parregullsive në raporte ia dërgon për rishikim GMS-së.

12. Kryetari miraton dhe dërgon për informim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore një kopje të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit, si dhe një relacion shpjegues mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të shoqëruar me treguesit e performancës së synuar dhe realizimin faktik të tyre për të gjitha programet buxhetore për vitin buxhetor pararendës. Pjesë e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit janë dhe raportet mbi treguesit financiarë sipas përcaktimeve të nenit 54, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Përgjegjësitë e Këshillit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

13. Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore informohet dhe diskuton mbi raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, të cilat paraqiten në këshill tri herë në vit (çdo 4 muaj). Gjithashtu, Këshilli ka të drejtë që për çështje specifike të kërkojë raportim të veçantë.

14. Këshilli miraton raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit mbi përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë, mbi përdorimin e fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë për garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

15. Në rast se nga monitorimi i zbatimit të buxhetit konstatohet nevoja për rishpërndarje të fondeve ndërmjet programeve buxhetore, mbi bazë të informacionit të mbledhur nga raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, të performancës së realizimit të objektivave kundrejt planit vjetor, duke respektuar kufijtë e miratuar në buxhetin vjetor të njësisë ose duke propozuar një buxhet shtesë, Këshilli vlerëson dhe miraton rishpërndarjen e fondeve buxhetore.

16. Këshilli miraton marrjen e masave për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore mbi bazë të raporteve katërmujore të monitorimit dhe rekomandimeve sipas rastit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore

17. “Nëpunës autorizues” është nëpunësi i nivelit më të lartë i njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat dhe programet buxhetore, duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin e kontroleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

18. Nëpunësi autorizues i nivelit të dytë është drejtuesi i njësisë shpenzuese të varësisë me të njëjtat përgjegjësi të nëpunësit autorizues për njësinë shpenzuese që drejton.

19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

21. Nëpunësi autorizues ka përgjegjësi të plotë për koordinimin e procesit të monitorimit të buxhetit vjetor. Ai është përgjegjës për monitorimin në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme të performancës së objektivave dhe performancës së produkteve në sasi dhe vlerë, si dhe për propozimin e zgjidhjeve të kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore (kur kjo kompetencë është deleguar) për përmirësimin e performancës kur identifikon shmangie të mëdha ndaj planit.

22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit, dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katërmujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet e realizuara për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm, sipas formateve dhe standardeve pjesë e këtij udhëzimi.

24. Nëpunësi autorizues në rolin e koordinatorit të GMS-së gjatë procesit të monitorimit të buxhetit vjetor:

- Rishikon raportet e monitorimit të nënshkruara nga Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) për të gjitha programet që përdor njësi e vetëqeverisjes vendore;

- Vlerëson realizimin e treguesve të performancës së planifikuar për arritjen e qëllimit, objektivave të programeve të shpenzimeve, si dhe realizimin e produkteve përkatëse, duke vlerësuar në mënyrë të

veçantë arrijtjet e objektivave të politikës së programit të njësisë. Verifikon shpjegimet e dhëna për shmangiet më të theksuara nga plani i performancës së programeve (treguesit e monitorimit të performancës së programeve buxhetore).

- Vlerëson masat korrigjuese që propozohen të ndërmerren, përcakton nëse duhen ndërmarrë veprime të mëtejshme dhe ku do të konsistojnë ato.

- Kërkon rishikimin e raporteve të përgatitura nga drejtuesit e EMP-së nëse është e nevojshme.

- Miraton dhe nënshkruan raportin përfundimtar për të gjitha programet e shpenzimeve buxhetore të njësisë. Një kopje të raportit e dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

25. Nëpunësi autorizues publikon në faqen zyrtare të njësisë, raportet e monitorimit, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit.

26. Me kërkesë të Këshillit, nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore raporton gjatë vitit edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.

Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues

27. Nëpunësi zbatues është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë, si dhe drejtuesve të programeve, informacionin e nevojshëm financiar për përgatitjen e raporteve përkatëse të monitorimit.

28. Nëpunësi zbatues ka rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ai mbështet nëpunësin autorizues gjatë procesit të përgatitjes së raporteve të monitorimit, nëpërmjet:

- Përgatitjes së informacionit financiar për shpenzimet faktike sipas: programeve; klasifikimit ekonomik të programit përkatës të periudhës së raportimit;

- Informimit të drejtuesve e programeve për çdo ndryshim në shpërndarjen e shpenzimeve të miratuara nga Grupi për Menaxhim Strategjik gjatë procesit të menaxhimit të shpenzimeve;

- Analizave financiare dhe jofinanciare (marrë kryesisht nga marrëveshjet kontraktuale dhe atyre të prokurimeve) për vitet e kaluara dhe vitin korrent; kryerjes së analizave përkatëse bazuar në informacionin financiar dhe jofinanciar të viteve të kaluara dhe vitit buxhetor aktual;

- Oponencës ndaj drejtuesve të programeve gjatë procesit të diskutimit të raporteve të monitorimit të programeve përkatëse;

- Hartimit të informacionit përmbledhës të shpenzimeve faktike të njësisë, nënshkrimit të planit të shpenzimeve dhe paraqitjes së tyre të nëpunësi autorizues;

- Mbledhjes, përditësimit dhe informimit për treguesit financiarë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

29. Nëpunësi zbatues ndihmon drejtuesit e programeve në llogaritjen e kostove për njësi të produkteve sipas programeve. Ai ndihmon në identifikimin e mundësive buxhetore për mbulimin e kostove për realizimin e produkteve që nuk mund të financohen plotësisht ose është i pamundur financimi i tyre me burimet e disponueshme ose rishpërndarjen e burimeve financiare brenda programit buxhetor.

30. Nëpunësi zbatues bashkëpunon me drejtuesit e EMP-së dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë, si dhe me anëtarët e ekipeve të menaxhimit të Programit për të identifikuar zgjidhjen e problemeve, në rastin e mospërputhjeve ndaj planit të treguesve të performancës së monitorimit të programeve.

Përgjegjësitë e drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit

31. Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP) është përgjegjës dhe raporton përpara nëpunësit autorizues për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit dhe propozon masa korrigjuese në rast kur kjo është e nevojshme.

32. Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit janë përgjegjës përpara nëpunësit autorizues për raportimin në kohë, dhe sipas standardeve të përcaktuara në këtë udhëzim të produkteve për programin përkatës që drejtojnë.

33. Drejtuesit e programit kanë përgjegjësinë për të marrë pjesë në takimet e Grupit për Menaxhimin Strategjik, në çdo diskutim, si dhe në vendimmarrjet përkatëse që kanë ndikim mbi programin të cilin drejtojnë.

34. Në mënyrë specifike ata janë përgjegjës, për:

- Hartimin e planit katërmujor të produkteve në sasi dhe në vlerë duke respektuar tavanet e përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

- Mbledhjen e të dhënave në lidhje me performancën e objektivave, performancën mbi secilin produkt në fund të katërmujorit dhe krahasimin e të dhënave faktike me planin e periudhës;

- Analizën e shkaqeve të mospërputhjeve/ shmangieve dhe marrjen e vendimeve në lidhje me veprimet korrigjuese, të nevojshme për përmirësimin e situatës;

- Në rast se një nga arsyet e shmangies ka qenë planifikimi i pasaktë atëherë është i nevojshëm rishikimi

i planit dhe përgatitja e një përmbledhjeje të rishikuar katërmujore të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve të programeve.

- Përgatitjen/rishikimin dhe nënshkrimin e raportit përmbledhës mbi bazën e raporteve paraprake të përgatitura nga anëtarët e EMP-së dhe dërgimin e tij tek anëtarët e GMS-së. Ky raport përmban:

- Të dhëna në lidhje me performancën e objektivave;
- Të dhëna në lidhje me performancën e çdo produkti;
- Analizën që shpjegon mospërputhjet e rëndësishme në lidhje me planin e periudhës;
- Veprimet korrigjuese që EMP-ja ka ndërmarrë ose që planifikon të ndërmarrë;
- Përmbledhjen e përditësuar të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve;
- Rekomandimet për veprime të mëtejshme për përmirësimin e situatës që i propozohen GMS-së për vendimmarrje;

- Identifikimin e ndikimit të çdo ndryshimi në realizimin e planit të vitit buxhetor në përgatitjen e kërkesave për PBA-në e ardhshme;

- Organizimin e takimeve të ekipit të menaxhimit të programit në etapa të ndryshme të procesit të monitorimit, sidomos përpara periudhave të raportimit;

- Harmonizimin e qëndrimeve kur anëtarët e EMP-së kanë mendime të ndryshme në lidhje me situata të caktuara dhe raportimin te koordinatori i GMS-së nëse nuk harmonizohen qëndrimet;

- Miratimin e të dhënave që hidhen në mënyrë elektronike (instrument financiar ose *software* i përdorur për këtë qëllim)/data bazën e njësisë së vetëqeverisjes vendore për monitorimin e zbatimit të buxhetit.

35. Mbi bazën e produkteve të përcaktuara drejtuesi i programit ka përgjegjësi të vlerësojë risqet që ndikojnë në arritjen e këtyre produkteve, mënyrën e trajtimit të tyre, si dhe kostot për minimizimin e risqeve. Risqet renditen sipas impaktit në realizimin e objektivit sipas të cilit është i lidhur produkti dhe diskutohen në Grupin e Menaxhimit Strategjik.

Përgjegjësitë e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit

36. Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit janë ekspertë të fushës së programit përkatës buxhetor/nëpunës autorizues të nivelit të dytë, përgjegjës për menaxhimin e programeve/ projekteve që ata drejojnë dhe përgjigjen për punën e tyre te drejtuesi i programit.

37. Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit janë përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të monitorimit të programit sipas këtij udhëzimi, të cilat lidhen direkt me performancën e produkteve të programit të tyre, të dhëna në sasi dhe në vlerë financiare, duke identifikuar problematikat e hasura në rast shmangieje ndaj planit, si dhe duke bërë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës. Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programeve kanë për detyrë:

- Të respektojnë afatet, cilësinë dhe standardet e raportimit të performancës së produkteve për programin përkatës sipas formateve dhe kërkesave të këtij udhëzimi;

- Të ndjekin udhëzimet e koordinatorit të GMS-së;

- Të marrin pjesë në takimet e EMP-së, sipas kalendarit të aktiviteteve të Ekipit të Menaxhimit të Programit të hartuar nga drejtuesi i programit;

- Të kontribuojnë në përgatitjen e raportit të monitorimit;

- Të mbledhin, përditësojnë dhe raportojnë në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të performancës së programit buxhetor ku ata bëjnë pjesë;

- Të koordinojnë me nëpunësin zbatues gjatë procesit të raportimit.

38. EMP-ja mban përgjegjësi për performancën e produkteve të planifikuara të programit që ata përfaqësojnë.

39. Mbi bazën e produkteve të përcaktuara Ekipi i Menaxhimit të Programit ka përgjegjësi të identifikojë risqet që ndikojnë arritjen e këtyre produkteve edhe objektivave për të cilët shërbejnë këto produkte, si dhe kostot për minimizimin e tyre dhe në vijim të hartojë regjistrin e riskut për programin që menaxhojnë.

Roli i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e monitorimit të buxhetit

40. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, monitoron periodikisht, zbatimin dhe përputhshmërinë e veprimtarisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyr në rastet e përcaktuara në ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si edhe në akte të tjera ligjore në fuqi.

41. Ministria e Financave dhe Ekonomisë merr raporte periodike të monitorimit për performancën e produkteve dhe të shpenzimeve nga njësitet e vetëqeverisjes vendore.

42. Për raportimet e ndërmjetme kur nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë vihet re problematikë serioze në zbatimin e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore, ministri i Financave dhe Ekonomisë përgatit një raport me komente e rekomandime dhe ia dërgon kryetarit dhe Këshillit të

Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore.

43. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgatit një raport me komente dhe rekomandime, brenda 30 ditëve pas dërgimit të raportit vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit të njesisë së vetëqeverisjes vendore, mbështetur në raportin e treguesve të performancës vjetore të objektivave dhe produkteve dhe të shpenzimeve të realizuara kundrejt planit vjetor të njesisë së vetëqeverisjes vendore.

44. Ministria e Financave dhe Ekonomisë i dërgon një kopje të këtij raporti kryetarit dhe Këshillit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

III. PROCEDURAT PËR PROCESIN E MONITORIMIT

Përcaktimi i vitit korrent

45. Viti i cili do të monitorohet, është viti i parë i PBA-së, që i korrespondon vitit buxhetor korrent/aktual. Kur procesi i PBA-së të ketë përfunduar, për vitin korrent janë përcaktuar:

- a) Shpërndarja e fondeve sipas programeve dhe zërave të klasifikimit ekonomik të shpenzimeve (artikujve), si dhe shpërndarja e fondeve për projektet, produktet;
- b) Produktet e parashikuara për secilin program;
- c) Kosto për njësi e planifikuar për secilin produkt;
- d) Ndarje 4-mujore për shpenzimet sipas produkteve;
- e) Zbatimi i planit strategjik të zhvillimit të njesisë së vetëqeverisjes vendore (planit të përgjithshëm vendor), strategji sektoriale.

46. Pas marrjes së udhëzimit plotësues të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e buxhetit vjetor, koordinatori i GMS-së udhëzon EMP-në të fillojë përgatitjen e raporteve të monitorimit sipas formateve, afateve dhe standardeve të përcaktuara në udhëzimin standard dhe plotësues të monitorimit të zbatimit të buxhetit. Koordinatorin i GMS-së përcakton datat e mbledhjeve të GMS-së që do të kryhen për të shqyrtuar raportet e monitorimit.

47. Procesin i përgatitjes së raportit të monitorimit duhet të nisë që në fillim të vitit. Drejtuesi i EMP-së, me qëllim sigurimin e të dhënave, duhet të koordinojë punën me specialistët teknikë përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, analizën, publikimin e të dhënave, veçanërisht me ata që kanë lidhje me shpenzimet dhe me statistikën.

Procedura për përgatitjen e raporteve katërmujore të monitorimit

48. Procesin i raportimit mbi performancën e produkteve për secilin program kërkon përgatitjen e tri raporteve periodike të monitorimit në vit. Raporti i katërmujorit të parë dhe katërmujorit të dytë dorëzohen në Këshillin e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe në drejtorinë përgjegjëse për financat vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit dhe, konkretisht, deri më 30 maj; 30 shtator, ndërsa raporti vjetor, brenda muajit shkurt të vitit të ardhshëm.

49. EMP-ja nën drejtimin e drejtuesit të Ekipit vlerëson ecurinë e treguesve të monitorimit të performancës së programeve, përgatit raportet përkatëse dhe propozon masa korrigjuese kur vihen re shmangie kundrejt planit. EMP-ja duhet të rishikojë çdo mospërputhje, të konsultojë stafin teknik kur është e nevojshme dhe të shpjegojë arsyet e mospërputhjeve. Kur rishikohet buxheti dhe/ose PBA-ja, EMP-ja propozon rishikimin e planit të treguesve të monitorimit të performancës.

50. DEMP-ja mbledh, përditëson dhe raporton te GMS-ja mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të performancës së programeve për të cilat ata janë përgjegjës. Treguesit e monitorimit japin informacion për objektivat dhe produktet e programeve përkatëse.

51. Mbi bazën e analizës së treguesve të performancës EMP-ja propozon ndryshime në strukturën e planit të shpenzimeve nëse ka shmangie, në mënyrë që të arrihen produktet e programeve për periudhat pasardhëse. Raporti i monitorimit jep masën e realizimit në përqindje të treguesve të performancës midis realizimit faktik dhe planit përkatës të tyre.

52. Kur EMP-ja ka sqaruar arsyet e mospërputhjeve dhe ka përcaktuar masat korrigjuese që do të ndërmerren, drejtuesi i EMP-së përgatit, nënshkruan dhe dërgon te GMS-ja një raport, i cili përmban:

- Monitorimin e treguesve të performancës së programeve buxhetore sipas standardeve të miratuara në këtë udhëzim;
- Relacion shpjegues për mospërputhjet kundrejt planit të periudhës raportuese;
- Masat korrigjuese që duhen ndërmarrë në rast mospërputhjeje.

53. Në bazë të rekomandimeve/masave korrigjuese të propozuara nga EMP-ja, si më sipër, GMS-ja propozon te kryetari i njesisë së vetëqeverisjes vendore ndërmarrjen e veprimeve përkatëse korrigjuese. Disa masa që kërkojnë vendimmarrje të kryetarit të njesisë apo Këshillit të njesisë, janë:

- Transferime fondesh ndërmjet programeve buxhetore;

- Transferim fondesh ndërmjet njësive shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtut program.

54. Në raportin e monitorimit të katërmujorit të dytë (tetëmuji) duhet përgatitur një informacion shtesë lidhur me parashikimin e realizimit të pritshëm të vitit korrent për të gjitha produktet e programeve të shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe për nivelin e realizimit të shpenzimeve të parashikuara.

55. Raportet e EMP-së marrin dakordësinë e të gjithë Ekipit, në të kundërt, kur ka mosmarrëveshje drejtuesi i EMP-së e paraqet qëndrimin e ndryshëm në GMS, si një pikë të veçantë të raportit përfundimtar për GMS-në.

56. Raportet e monitorimit të të gjitha EMP-ve, të cilat janë prezantuar dhe miratuar nga GMS-ja përmbledhen në një raport përfundimtar monitorimi dhe nënshkruhen nga koordinatori i GMS-së dhe drejtuesit e EMP-ve. Ato u dërgohen deri në fund të javës së katërt të periudhës së monitorimit Këshillit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

57. Në rastet kur GMS-ja nuk arrin marrëveshje, drejtuesi i GMS-së ka të drejtë të marrë vendimin.

IV. TË TJERA

58. Procedura të tjera shtesë lidhur me procesin e monitorimit, jepen në shtojcat bashkëlidhur këtij udhëzimi, përkatësisht:

- Shtojca 1 “Afatet kohore për monitorimin e buxhetit”;
- Shtojca 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit”;
- Shtojca 3 “Procedura në rastin e një buxheti të rishikuar gjatë vitit korrent”;
- Shtojca 4 “Procedura në rastin e ndryshimeve të alokimeve financiare në vitin korrent”;
- Shtojca 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”.

59. Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit duhet të përmbajë anekset e mëposhtme, pjesë e këtij udhëzimi dhe të detyrueshme për t’u zbatuar:

- Aneksi nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”;
- Aneksi nr. 2 “Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetorë”;
- Aneksi nr. 3 “Raporti i realizimit të produkteve të programit”;
- Aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”;
- Aneksi nr. 5 “Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj”.

60. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

SHTOJCË 1
AFATET KOHORE PËR MONITORIMIN E BUXHETIT

Në mënyrë të përmbledhur i gjithë procesi i monitorimit të zbatimit të buxhetit me afatet kohore, personat përgjegjës dhe dokumentet e prodhuara jepet në skemën e mëposhtme:

Produkti	Koha/afati	Përgjegjës	Dokumenti prodhuar
Përgatitja e treguesve të performancës	Janar viti korrent	EMP-ja	Treguesit e monitorimit të performancës së programeve buxhetore të ndara në: - Produkte për arritjen e objektivave të programeve; - Kosto për njësi produktesh të prodhuara. Lista e treguesve të performancës është pjesë e buxhetit vjetor dhe PBA-së.
Përgatitja e raportit I të monitorimit	1–15 maj viti korrent	Drejtuesi i EMP-së	Raporti I, i cili përmban: - Realizimin faktik të treguesve të performancës së programeve buxhetore (në vlerë dhe % kundrejt planit); - Relacion shpjegues për mospërputhjet kundrejt planit të periudhës raportuese; - Masat korrigjuese që duhen ndërmarrë në rast mospërputhjeje.
Diskutimi dhe miratimi i Raportit I në GMS	15–25 maj viti korrent	GMS-ja dhe koordinatori i GMS-së	Raporti I miratuar nga GMS-ja - Vlerësimi i raporteve të monitorimit të EMP-së; - Marrja e vendimeve në rastet e mosdakordësisë të EMP-së.
Raportimi në Këshill dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	30 maj viti korrent	Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore	Raporti I monitorimit të zbatimit të buxhetit. Periudhat që përmban raporti: - Vitin buxhetor / korrent - Katërmujori i parë; vitit korrent (1.1.20XX --- 30.4.20XX); - Dy vitet pararendëse. Raporti përfshin: - Të dhënat faktike dhe masën e realizimit në përqindje kundrejt planit të periudhës dhe krahasimin në përqindje kundrejt realizimit faktik të periudhave të mëparshme; - Analizën e mospërputhjeve dhe masave për përmirësimin e situatës; - Treguesit e monitorimit të performancës së programeve buxhetore.
Publikimi i raportit I	30 maj viti korrent	Nëpunësi autorizues	Informacion i aksesueshëm në faqen zyrtare të njësisë vendore.
Komente mbi raportin I, drejtuar: - Kryetarit të njësisë; - Këshillit të njësisë vendore.	30 qershor viti korrent	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shkresa e MFE-së, e cila përmban: - Komente dhe rekomandime në lidhje me treguesit e performancës të raportuar; - Rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës në rastet e konstatimit të vështirësive financiare.
Përgatitja e Raportit II të monitorimit	1–15 shtator viti korrent	Drejtuesi i EMP-së	Raporti II, i cili përmban: - Realizimin faktik të treguesve të performancës së programeve buxhetore (në vlerë dhe % kundrejt planit); - Parashikim për realizimin e pritshëm deri në fund të vitit korrent; - Relacion shpjegues për mospërputhjet kundrejt planit të periudhës raportuese; - Masat korrigjuese që duhen ndërmarrë në rast mospërputhjeje.
Diskutimi dhe miratimi i Raportit II në GMS	15–25 shtator viti korrent	GMS-ja dhe koordinatori i GMS-së	Raporti II miratuar nga GMS-ja - Vlerësimi i raporteve të monitorimit të EMP-së; - Marrja e vendimeve në rastet e mosdakordësisë nga EMP-ja.

Raportimi në Këshill dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:	30 shtator viti korrent	Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore	Raporti II i monitorimit të zbatimit të buxhetit. Periudhat që përmban raporti: - Vitin buxhetor / korrent - Katërmujori i dytë (progresiv); vitit korrent (1.5.20XX --- 31.8.20XX); - Dy vitet pararendëse. Raporti përfshin: - Të dhënat faktike dhe masën e realizimit në përqindje kundrejt planit për të njëjtën periudhë dhe krahasimin në përqindje kundrejt realizimit faktik të periudhave të mëparshme; - Analizën e mospërputhjeve dhe masave për përmirësimin e situatës. - Treguesit e monitorimit të performancës së programeve buxhetore; - Masën e parashikimit të pritshëm të realizimit të treguesve të performancës deri në fund të vitit.
Publikimi i raportit II	30 shtator viti korrent	Nëpunësi autorizues	Informacion i aksesueshëm në faqen zyrtare të njësisë vendore
Komente mbi raportin II, drejtuar: - Kryetarit të njësisë; - Këshillit të njësisë vendore.	30 tetor viti korrent	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shkresa e MFE-së, e cila përmban: - Komente dhe rekomandime në lidhje me treguesit e performancës të raportuar.
Përgatitja e raportit III të monitorimit	1-15 janar viti korrent	Drejtuesi i EMP-së	Raporti III, i cili përmban: - Realizimin faktik të treguesve të performancës së programeve buxhetore (në vlerë dhe % kundrejt planit); - Relacion shpjegues për mospërputhjet kundrejt planit të periudhës raportuese dhe planit vjetor; - Masat korrigjuese që janë ndërmarrë për çdo rast mospërputhjeje.
Diskutimi dhe miratimi i Raportit III në GMS	15–25 janar viti parardhës	GMS-ja dhe koordinatori i GMS-së	Raporti III miratuar nga GMS-ja - Vlerësimi i raporteve të monitorimit të EMP-së; - Marrja e vendimeve në rastet e mosdakordësisë nga EMP-ja.
Raportimi në Këshill dhe Ministrinë e Financave	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës	Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore	Raporti III (vjetor) i monitorimit të zbatimit të buxhetit. Periudhat që përmbajnë raportet: - Vitin buxhetor / korrent, periudha (1.1.20XX --- 31.12.20XX). Raporti përfshin: - Të dhënat faktike dhe masën e realizimit në përqindje kundrejt planit të periudhës dhe krahasimin në përqindje kundrejt realizimit faktik të periudhave të mëparshme; - Të dhënat faktike dhe masën e realizimit në përqindje kundrejt planit vjetor dhe krahasimin në përqindje kundrejt realizimit faktik të dy viteve paraardhëse; - Analizën e mospërputhjeve dhe masave që janë marrë për përmirësimin e situatës; - Treguesit e monitorimit të performancës së programeve buxhetore të katërmujorit të tretë dhe ata vjetorë. - Treguesit kyçë financiarë vjetorë.
Publikimi i Raportit III dhe vjetor	Brenda muajit shkurt viti pasardhës	Nëpunësi autorizues	Informacion i aksesueshëm në faqen zyrtare të njësisë vendore
Komente mbi raportin III, drejtuar: - Kryetarit të njësisë; - Këshillit të njësisë vendore.	Mars viti pasardhës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shkresa e MFE-së, e cila përmban: - Komente dhe rekomandime në lidhje me treguesit e performancës të raportuar; - Në rastet e konstatimit të vështirësisë financiare rekomandime konkrete për

			rregullimin e situatës së vështirësisë financiare.
--	--	--	--

SHTOJCË 2 PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT

Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit përfshin informacion mbi realizimin e zbatimit të buxhetit sipas përmbytjes së këtij udhëzimi. Dokumenti, në mënyrë të përmbledhur, duhet të përmbyjë:

1. Përmbytja e raportit
 - 1.1 Lista e përmbytjes së raportit të monitorimit (statistikat dhe përshkrimet e gjithë dokumentit).
2. Hyrje
 - 2.1 Përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit.
3. Plotësimi i formateve të përcaktuara në këtë udhëzim (të gjitha anekset bashkëlidhur), ku të dhënat janë të rakorduara me planin e periudhës së buxhetit dhe realizimin faktik të thesarit sipas Sistemit Information Financiar të Qeverisë (SIFQ).
 - 3.1 Raporti i shpenzimeve sipas programeve;
 - 3.2 Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetorë;
 - 3.3 Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit;
 - 3.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit;
 - 3.5 Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj.
4. Relacion shpjegues për çdo format të sipërcituar:
 - Rezultatet sipas programeve, identifikimin e mospërputhejve, masat e marra për përmirësimin e situatës;
 - Për gjithë njësinë e vetëqeverisjes vendore jepet një përshkrim në lidhje me masën e realizimit të treguesve të performancës;
 - Aty ku është e mundur raporti shoqërohet me opinionin e auditit të brendshëm dhe ose të jashtëm të dhënë për këtë qëllim;
 - Ecurinë e realizimit të qëllimeve dhe objektivave të politikës që trajtojnë çështjen e barazisë gjinore nëpërmjet treguesve të performancës;
 - Realizimin e produkteve në krahasim me planin si në terma sasiorë ashtu edhe në vlerë duke evidentuar edhe koston për njësi, si dhe nënvizimin e argumenteve konkrete lidhur me rishikimin ose jo të politikës së programit apo propozime të tjera për përmirësimin e situatës;
 - Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli;
 - Analiza e të dhënave mbi realizimin e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj;
 - Raportimin e nivelit, kohëzgjatjes dhe strukturës së detyrimeve tatimore të evidentuara e të paarkëtuara në kohë.
 - Për treguesit e performancës, fillimisht përcaktohen/maten vlerat bazë të treguesve të performancës dhe vendosen synime realiste. Viti i parë i vendosjes së treguesve duhet të shërbejë për të raportuar mbi vlerat bazë të treguesve, e më pas vendosen synimet dhe monitorohet realizimi i tyre.

SHTOJCË 3 PROCEDURA NË RASTIN E NJË BUXHETI TË RISHIKUAR GJATË VITIT KORRENT

Në rastet kur Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes vendore miraton një buxhet të rishikuar apo nëse rishikohet buxheti qendror me miratim të Kuvendit (dhe kur ky i fundit prek transfertat e qeverisë për njësitë e vetëqeverisjes vendore), duke prekur/ rishikuar alokimet sipas programeve, artikujve dhe burimeve të financimit të tyre, njësia e vetëqeverisjes vendore rishikon planin e produkteve për ata tregues performance që preken nga rishikimi i buxhetit.

Për këtë, koordinatori i GMS-së udhëzon EMP-në të përgatisin rishikimin e planeve për vitin korrent sipas afateve që përcaktohen nga urdhri që shpërndahet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Rishikimi i planeve nis me identifikimin e natyrës së ndryshimeve duke i krahasuar me alokimet e mëparshme. Në dakordësi me të gjithë anëtarët e EMP-së përgatitet impakti i ndryshimeve buxhetore në arritjen e objektivave, projekteve, produkteve dhe në alokimin e burimeve sipas artikujve për vitin korrent.

Ndryshimi i planit reflektohet në ndryshimin e produkteve të treguesve të performancës në sasi dhe në vlerë (kur bëhet fjalë për tregues inputi – kosto për njësi për produktet e synuar që të prodhohen).

EMP-ja duhet më pas të diskutojë, konsultojë me stafin teknik sipas nevojës dhe të arrijë marrëveshje në lidhje me ndryshimet që do t'i bëhen planit, në mënyrë që plani të përshtatet me alokimet e rishikuara. Për këtë duhet të marrë në konsideratë faktin nëse ndryshimet e propozuara do të kenë impakt mbi objektivat,

standardet, projektet, produktet, në alokimin e burimeve, sipas artikujve, nëse ka ndryshime ndërmjet lidhjes së produkteve me objektivat, ndërmjet produkteve dhe proceseve politike. Implikimet dhe ndryshimet e propozuara si në objektiva dhe në standarde duhet të reflektohen në procesin e ardhshëm të PBA-së.

Në përputhje me afatet e parashikuara nga urdhri i kryetarit të njësisë drejtuesi i EMP-së dorëzon te koordinatori i GMS-së ndryshimin e planit, i cili përmban:

- a) Deklaratën e politikës së programit;
- b) Shpenzimet e programit sipas produkteve;
- c) Projektet me financim të brendshëm;
- d) Projektet me financim të huaj;
- e) Një profil katërmujor të rishikuar të shpenzimeve dhe produktet e synuara (nga ana sasiore).

Koordinatori i GMS-së shqyrton raportet e të gjitha programeve buxhetore të njësisë, planet e të cilave janë prekur nga ndryshimi i buxhetit. Koordinatori i GMS-së së bashku me drejtuesit e EMP-ve nënshkruajnë raportet e monitorimit dhe i dorëzohen për miratim kryetarit të njësisë dhe dorëzohen në këshill.

SHTOJCË 4

PROCEDURA NË RASTIN E NDRYSHIMEVE TË ALOKIMEVE FINANCIARE NË VITIN KORRENT

Të gjitha vendimet dhe veprimet gjatë vitit kanë si referencë planin vjetor. Nëse ka argumente të arsyeshme plani vjetor është subjekt ndryshimi. Faktorë që çojnë në ndryshimin e planit, janë:

a) Ngjarje të paparashikuara dhe të parashikuara, si p.sh., emergjenca të cilat tejkalojnë fondet e parashikuara të rezervës dhe kontigjencës.

b) Nevoja për rishikimin e kostove dhe/ose kohës jo të mjaftueshme për zbatimin e programeve si rrjedhojë e parashikimeve jo të sakta;

c) Moti i keq ose ndryshimi i çmimit të materialeve dhe/ose shërbimeve.

Nëse plani sugjeron ndryshime në alokimin e burimeve financiare për rrjedhojë është e nevojshme bërja e ndryshimeve në objektiva, në sasinë ose cilësinë e produkteve të treguesve të performancës që planifikohet të realizohen sipas programeve të shpenzimeve që preken nga ndryshimet e planit buxhetor.

Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar.

Ndryshimet e mundshme në alokimin e të ardhurave mund të marrin formën e:

- Transferimit të burimeve ndërmjet produkteve në të njëjtin program;
- Transferimit të burimeve ndërmjet artikujve në të njëjtin program;
- Transferimit të burimeve ndërmjet programeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ndryshimet brenda programeve

Nëse gjykohet që ndryshimi i planit buxhetor sjell nevojën e mbulimit të impaktit në arritjen e objektivave të përgjithshëm të bashkisë duke transferuar fonde/burime brenda të njëjtit program të njësisë, atëherë drejtuesit e EMP-ve duhet të konkludojnë në dakordësinë midis anëtarëve të EMP-së që janë pjesë e nënprogrameve që preken për reflektimin e ndryshimeve përkatëse. Për këtë arsye bëhen llogaritje në lidhje me planifikimin e sasisë së produkteve që do të mbulohen, si rrjedhojë e fondeve të ndryshuara (shtuara, pakësuara) përkatësisht. Duhet të merret në analizë cilësia e prodhimit të produkteve në rastin e rishikimit të planit. Në çdo rast duhet të synohet ruajtja e një standardi minimal të ofrimit të shërbimit për programet përkatëse.

Të gjitha ndryshimet duhet të shoqërohen me një relacion të argumentuar në lidhje me veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë. Nëse ndryshimi i buxhetit parashikon krijimin e produkteve të reja ose projekteve të reja, mbështetur në një analizë të detajuar që duhet të paraqitet mbi domosdoshmërinë e krijimit të produkteve apo projekteve të reja, si dhe impaktin që kanë ato në përmbushjen e planit, miratimi është subjekt i këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kur transfertat nuk përfshijnë krijimin e produkteve të reja ose të projekteve të reja, nëpunësi autorizues duhet të udhëzojë drejtuesin e EMP-së për të përgatitur materialet e nevojshme të nëpunësi zbatues me qëllim që të bëjnë të mundur realizimin e transfertës sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Për projektet e reja të investimeve publike, nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të udhëzojë EMP-në për të përgatitur materialet e nevojshme për të realizuar rialokimin sipas udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Ndryshimet ndërmjet programeve

Nëse gjykohet që ndryshimi i planit buxhetor sjell nevojën e mbulimit të ndikimit në arritjen e objektivave

të përgjithshëm të njësisë duke transferuar fonde/burime nga një program buxhetor te një program tjetër buxhetor i njësisë së vetëqeverisjes vendore, atëherë drejtuesit e EMP-ve përkatëse duhet të dakordësojnë me njësitë shpenzuese që preken për reflektimin të ndryshimeve përkatëse. Drejtuesit e EMP-ve duhet të arrijnë në marrëveshje në lidhje me:

- Shumën e fondeve që kërkohen në secilin rast dhe artikujt që do të përfshihen në transfertë;
- Produktin që do të realizohet;
- Ndikimin e transfertës në objektivat dhe/ose standardet e programit;
- Programet nga të cilat EMP-ja propozojnë të transferohen burime, duke përfshirë një justifikim se pse burimet duhet të alokohen në këto programe.

Informacioni i mësipërm duhet të jetë pjesë e relacionit shpjegues mbi veprimet korrigjuese të ndërmarra i cili dorëzohet te nëpunësi autorizues/ koordinatori i GMS-së.

Nëpunësi autorizues duhet të përgatisë një kërkesë për Këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për rialokimin e fondeve midis programeve. Kërkesa duhet të paraqesë ndikimin e pritshëm mbi objektivat, produktet dhe shpenzimet e produkteve për secilin program të përfshirë në propozimin e transfertës.

Pasi kërkesa miratohet nga Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpunësi autorizues duhet të udhëzojë drejtuesin e EMP-së për të përgatitur materialet e nevojshme në mënyrë që transfertat të realizohet sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin nr. 9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Pasi është arritur dakordësia në lidhje me ndryshimet përkatëse rishikohet plani i produkteve për atë që preken fondet e programeve përkatëse (në rritje ose në rënie) dhe dërgohet plani i rishikuar për miratim të kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore e më tej në Këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në rast se GMS-së nuk arrin marrëveshjen, për rialokimin e fondeve midis programeve kryetari i GMS-së ka të drejtën të vendosë për më tej.

SHTOJCË 5 TREGUESIT E MONITORIMIT TË PERFORMANCËS SË PROGRAMEVE DHE TREGUESIT FINANCIARË

Programet e shpenzimeve monitorohen për të siguruar transparencë në lidhje me performancën e tyre për këtë qëllim hartohen tregues performance. Treguesit e performancës përdoren për të monitoruar arritjen e objektivave dhe efektivitetin e operacioneve. Në nivel programi shpenzimesh buxhetore ato përdoren për të monitoruar arritjen e objektivave të programit. Treguesit e monitorimit të performancës duhet të jenë:

- i. lehtësisht të kuptueshëm;
- ii. specifikkë e të lidhur ngushtësisht me qëllimin e politikës së programit dhe objektivat që synohen të arrihen përmes tij;
- iii. lehtësisht të matshëm;
- iv. të identifikueshëm.

Njësia e vetëqeverisjes vendore harton tregues performance për çdo program shpenzimesh. Gjatë vitit (në tri periudha 4-mujore) monitorohen treguesit në mënyrë që të krahasohet realizimi i tyre faktik me nivelin e planifikuar. Përmes kësaj sigurohen korrigjimet e nevojshme lidhur me performancën e arrirë për çdo program.

Për të gjitha funksionet e veta ligjore njësia e vetëqeverisjes vendore monitoron të gjitha programet e shpenzimeve të saj duke krijuar një sistem administrimi të performancës së shërbimeve publike që ajo ofron për komunitetin vendor bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare. Për këtë qëllim njësia e vetëqeverisjes vendore harton një sistem treguesish performance.

Në lidhje me funksionet e deleguara nga institucionet qendrore dhe me synim garantimin e zbatimit të normave dhe standardeve kombëtare të krijuara në legjislacionin përkatës në fuqi dhe në përputhje me parimin e autonomisë vendore, ministritë e linjës të fushave përkatëse të përgjegjësisë, kanë të drejtë të mbikëqyrin dhe monitorojnë veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore për ato funksione që ato kanë deleguar te njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Treguesit e performancës duhet të përcaktohen në nivel produktesh dhe rezultatesh në mënyrë që ta drejtojnë programin buxhetor drejt efektivitetit. Treguesit në nivel produkti tregojnë mallra dhe shërbime që duhen ofruar/prodhuar për arritjen e objektivave afatmesëm dhe qëllimeve afatgjata të programit. Nëse informacioni i programeve të shpenzimeve në lidhje me produktet/treguesit në nivel produkti kombinohet me informacion të saktë në lidhje me koston e programit, kjo gjë bën të mundur analizën e eficiencës së të gjithë programit.

Më poshtë jepen shembuj treguesish performance për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve bashkiake për

të gjitha llojet e niveleve të treguesve.

Lloji i treguesit të performancës në nivel	Përshkrimi	Shembull
Produkti/output (sasi e prodhuar)	Shërbime të ofruara të klientët/ qytetarët	Tonë mbetje të mbledhura nga familjet ose bizneset
Rezultati	Efekti mbi çështjet sociale - ekonomike	Përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe higjienës publike
Impakti	Perceptimi i qytetarëve në lidhje me politikat e bashkisë	Besimi i qytetarëve në politikat e bashkisë
Eficiencë input (kosto për njësi e prodhuar)	Burimet financiare për çdo njësi produkti	Kosto e një ton mbetje bashkiake të mbledhur/ përpunuar etj.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë tregues performance për të gjitha programet e shpenzimeve buxhetore që ato përdorin. Hartimi i treguesve është detyrë e një grupi të gjerë aktorësh, si: kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, drejtuesi i programit buxhetor dhe aktorë jashtë njësisë, të cilët kanë njohuri në lidhje me programin përkatës.

Nëpërmjet udhëzimeve vjetore të përgatitjes së buxhetit afatmesëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me ministrinë e linjës mund të ndajë me njësitë e vetëqeverisjes vendore tregues standardë minimalë, bazuar në legjislacionin specifik.

Për funksionet e deleguara treguesit e monitorimit të performancës duhet të jenë të njëjtë për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për funksionet e veta njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin tregues të lidhura ngushtësisht me karakteristikat e njësisë.

Treguesit financiarë

Treguesit financiarë përdoren për të vlerësuar qëndrueshmërinë financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore, informuar aktorët kryesorë, si: kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, komunitetin vendor, taksapaguesit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ose kreditorët.

Analiza dhe raportimin i treguesve financiarë i mundëson njësisë të kuptojë më mirë aspektet financiare të saj dhe njësive administrative. Ky informacion i kombinuar me element të tjerë ekonomik, demografik dhe social të njësisë ndihmon analizën dhe marrjen e masave përkatëse nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për të bërë krahasime midis tyre dhe mbajtjen e financave vendore nën monitorim.

Me anë të analizës së treguesve financiarë merret informacion në lidhje me:

- Cilat janë prioritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Çfarë burimesh ka në dispozicion njësia;
- Si përdoren fondet publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Sa varet njësia nga transfertat e qeverisë qendrore;
- Nëse po ruhet disiplina fiskale;
- Nëse ka risqe fiskale që kërkojnë një vëmendje të veçantë.

Analiza financiare duhet të vlerësohet përgjatë viteve. Në këtë mënyrë monitorohen ndryshimet e kushteve financiare bazuar në të njëjtin tregues financiarë për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Bazuar në këta tregues Ministria e Financave dhe Ekonomisë jep rekomandime për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Drejtorja që merret me buxhetin dhe financën brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për të përgatitur, llogaritur, përditësuar dhe raportuar treguesit financiarë. Të dhënat për të llogaritur këta tregues financiarë mund të merren nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) duke iu referuar të dhënave faktike. Për të dhënat e planifikuara/buxhetuara, treguesit llogariten duke përdorur të dhënat nga buxheti.

Përllogaritja e këtyre treguesve financiarë do të mbështetet edhe në të dhënat që sigurohen nga Instrumente të Planifikimit Financiar ose software të ndryshëm të miratuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Të dhënat për të llogaritur vlerat faktike të treguesve financiarë mbledhen në mënyrë të përvitshme. Për shifrat e parashikuara të treguesve financiare, përdoren të dhënat e programit të buxhetit dhe PBA-së. Të gjitha të dhënat për llogaritjen e treguesve financiarë janë vjetore përveç treguesve të mëposhtëm të cilët kërkojnë të dhëna të akumuluar:

- Raporti i borxhit afatgjatë kundrejt totalit të të ardhurave (huamarrja është e dhënë e akumuluar për huamarrjen afatgjatë; totali i të ardhurave është e dhënë vjetore);
- Raporti i borxhit afatshkurtër kundrejt të ardhurave të veta të njësisë (huamarrja është e dhënë e akumuluar për huamarrjen afatshkurtër; totali i të ardhurave nga burimet e veta është e dhënë vjetore);
- Raporti i detyrimeve të papaguara në afat kundrejt të ardhurave nga taksat dhe tarifat (detyrimet e prapambetura kërkon të dhëna të akumuluar nga detyrimet e papaguara; të ardhurat nga taksat dhe tarifat është e dhënë vjetore).

Të gjithë treguesit financiarë llogariten dhe përditësohen në mënyrë të përvitshme dhe i referohen vitit të fundit (t-1); vitit korrent (t) dhe tri viteve të ardhshme. Treguesit financiarë raportohen çdo vit në Këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë i përdor treguesit e performancës dhe jep komente sipas rastit mbi objektivat e vendosur nga njësia për të cilat matet performanca.

Treguesit financiarë (sipas përcaktimeve të nenit 54, të ligjit nr. 68/2017)

Nr.	Treguesit kyçë financiarë	Kuptimi	Formula	Fakti viti (t-1)	Plani viti (t)	Plani viti (t+1)	Plani viti (t+2)	Plani viti (t+3)
1 ^{*1}	Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme	Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave—raporti tregon sesa shpenzon njësia për ofrimin e shërbimeve publike. Tregon marrëdhënien midis flukseve hyrëse të të ardhurave me flukset dalëse të shpenzimeve.	$\frac{\text{Shpenzime}}{\text{Ardhura}} * 100$					
2*	Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme	Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Rritja e raportit në vite tregon se njësia nuk mbështetet vetëm në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)	$\frac{\text{Të ardhurat e veta}}{\text{Të ardhurat e Përgjithshme}} * 100$					
3*	Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj planit të tyre	Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë është e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.	$\frac{\text{Të ardhurat faktike nga taksat dhe tarifatat}}{\text{Plani i taksave dhe tarifave}} * 100$					
4*	Raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Një normë e lartë një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore. Rritja e raportit përgjatë viteve mund të shpjegohet edhe me shërbime shtesë, infrastrukturë e re, pasuri të paluajtshme të shtuara, funksione të reja të marra që kanë nevojë për investime etj.	$\frac{\text{Shpenzimet kapitale}}{\text{Shpenzime të përgjithshme}} * 100$					
5*	Raporti i shpenzimeve për	Rritja në vite e peshës së shpenzimeve të personelit ndaj	$\frac{\text{Shpenzimet e personelit}}{\text{Shpenzime të përgjithshme}} * 100$					

¹ Treguesit me këtë shenjë gjenerohen në mënyrë automatike nga Instrumenti i Planifikimit Financiar për njësitë e vetëqeverisjes vendore

	personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme	shpenzimeve të përgjithshme mund të tregojë ulje të shpenzimeve për investime/operative, ose faktin se produktiviteti i personelit është në rënie. Një rritje e këtij raport mund të tregojë gjithashtu se qeveria po ofron më shumë shërbime (duke marrë funksionet të reja, duke rritur volumin e shërbimeve ose cilësinë e tij).						
6*	Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të përgjithshme	Afatgjatë mbi një vit Një raport i ulët tregon që NJQV-ja është në gjendje të paguajë detyrimet e saj të borxhit (principali plus interesat). Nëse NJQV-ja po paguan një përqindje të lartë të të ardhurave totale në shërbimin e borxhit, ato mund të detyrohen të ulin shërbimet e tjera lokale.	$\frac{\text{Borxhi afatgjatë i akumuluar}}{\text{Të ardhurat e përgjithshme}} * 100$					
7*	Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	I njëjti interpretim si më sipër. Raporti në këtë rast tregon qartë një varësi midis shërbimit të borxhit / shlyerjes me anë të burimeve të veta financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore	$\frac{\text{Borxhi afatgjatë i akumuluar}}{\text{Të ardhurat e Veta}} * 100$					
8*	Raporti i huamarrjes afatshkurtër ndaj të ardhurave të përgjithshme	Afatshkurtër nën një vit Tregon aftësinë e njësisë vendore për të respektuar detyrimet afatshkurtra. Rritja e detyrimeve korrente afatshkurtra si % kundrejt të ardhurave në fund të vitit tregon një situatë negative në lidhje me likuiditetet dhe / ose problem me shpenzimet të cilat realizohen me borxh. Një raport i ulët tregon se borxhi afatshkurtër mund të shlyhet	$\frac{\text{Borxhi afatshkurtër}}{\text{Të ardhurat e përgjithshme}} * 100$					

		lehtësisht me anë të të ardhurave vjetore të njësisë.						
9*	Raporti i detyrimeve tatimore të papagjuara në kohë ndaj të ardhurave tatimore	Përfaqëson detyrimet fiskale të papaguara në kohë për njësinë vendore. Një normë e lartë e detyrimeve të akumuluar kundrejt totalit të të ardhurave të njësisë nga taksat dhe tarifat mund të tregojë procedura jo të mira; barrë e lartë fiskale; rënie të ekonomisë vendore.	$\frac{\text{Detyrimet tatimore të prapambetura}}{\text{Të ardhurat nga taksat dhe tarifat}} * 100$					
10	Raporti i shpenzimeve për partneritetet publike-private ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Raporti i shpenzimeve që bën njësi si pjesë e të gjitha skemave PPP ku ajo është palë nuk duhet të jetë më shumë sesa 5% e shpenzimeve të përgjithshme të saj. Raporte më të larta tregojnë se njësi është në kundërshtim me parashikimet ligjore numër 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar.	$\frac{\text{Shpenzimet e njësisë për PPP}}{\text{Shpenzimet e përgjithshme të njësisë}} * 100$					
11*	Raporti i shpenzimeve për politikën e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Një raport i lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.	$\frac{\text{Shpenzimet për shërbimet sociale}}{\text{Shpenzimet e përgjithshme}} * 100$					
12	Raporti i shpenzimeve për politikën që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Njësi përdor fonde për politika që mbështesin çështjet gjinore dhe një raport në rritje përgjatë viteve tregon angazhimin në rritje të njësisë në këtë fushë.	$\frac{\text{Shpenzimet për çështjet e barazisë gjinore}}{\text{Shpenzimet e përgjithshme}} * 100$					

ANEKSI NR. 1
RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

në 000/lekë

Emri i grupit		Kodi i grupit						
Programet		Shpenzimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore						
Titulli	Emërtimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti _____	(2) PBA Viti _____	(3) Buxheti vjetor Plan Fillestar Viti _____	(4) Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti _____	(5) Buxheti vjetor Plani i Periudhës/progresiv	(6) Fakti i Periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
0001	Programi 1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
.....								
Totali i shpenzimeve të njësisë		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	

Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	
	Firma	
	Data	

ANEKSI 2
RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS ARTIKUJVE

ne 000/lekë

Bashkia							Kodi i grupit / Njesisë vendore	
Programi							Kodi i programit	
Art.	Emërtimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti _____	-2 PBA Plan Viti _____	-3 Buxheti vjetor Plan fillestar viti _____	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti _____	-5 Buxheti vjetor Plani i periudhës/progresiv	-6 Fakti i periudhës/progresiv	(7)=(6)-(-5) Diferenca
600	Paga							0
601	Sigurime shoqërore							0
602	Mallra dhe shërbime të tjera							0
603	Subvencione							0
604	Transferta korrente të brendshme							0
605	Transferta korrente të huaja							0
606	Trans për buxh. fam. & individ							0
Nëntotali	Shpenzime korrente	0	0	0	0	0	0	0
230	Kapitale të patrupëzuara							0
231	Kapitale të trupëzuara							0
232	Transferta kapitale							0
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	0	0	0	0	0	0	0
230	Kapitale të patrupëzuara							0
231	Kapitale të trupëzuara							0
232	Transferta kapitale							0
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime kapitale	0	0	0	0	0	0	0
Totali (korrente + kapitale)		0	0	0	0	0	0	0
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Kryetari i Njesisë Vetëqeverisjes Vendore			Emri			
	Firma				Firma			
	Data				Data			

ANEKSI NR. 3

RAPORTI PËRMBLEDHËS I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË PERFORMANCËS/PRODUKTEVE TË PROGRAMIT

Emri i Grupit		Kodi i grupit	
Programi		Kodi i programit	

	Në 000/lekë				I			II			III			IV	Luhatjet në koston për njësi			
Kodi	Emërtimi i treguesit të performancës/ produktit	Njësia matëse	Sasia faktike (sipas vitit paraardhës e)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhës e)	Kosto për njësi (sipas vitit paraardhës)	Sasia (sipas planit të vitit korrent)	Shpenzimet (sipas planit të vitit korrent)	Kosto për njësi (sipas planit të vitit korrent)	Sasia (sipas planit të rishiku ar të vitit korrent)	Shpenzimet (sipas planit të rishiku ar të vitit korrent)	Kosto për njësi (sipas planit të rishiku ar të vitit korrent)	Sasia faktike (në fund të vitit korrent)	Shpenzimet faktike (në fund të vitit korrent)	Kosto për njësi faktike (në fund të vitit korrent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	Koment e
A	Produkti				#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
B	Produkti				#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
C	Treguesi i performancës				#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
D	Produkti				#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Kryetari i Njësise së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	

Shëmbull:															Luhatjet në koston për njësi		
					I			II			III			IV	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
Kodi i Produktit	Emërtimi i produktit	Njësia matëse	Sasia (v.2015)	Shpenzimet (v.2015)	Kosto për njësi (v.2015)	Sasia (v.2016)	Shpenzimet (v.2016)	Kosto për njësi (v.2016)	Sasia e rishiku ar (v.2016)	Shpenzimet e rishikuara (v.2016)	Kosto për njësi e rishiku ar (v.2016)	Sasia (faktike 2016)	Shpenzimet (faktike 2016)	Kosto për njësi (faktike 2016)	Diferenca	Diferenca	Diferenca
C	Të trajnuar në drejtoritë rajonale të formimit profesional	numër	10,100	213,137	21	11,000	240,000	22	9,000	240,000	27	17,524	194,739	11	-47.3%	-49.1%	-58.3%
D	Persona të trajtuar me pagesë papunësie	numër	10,000	800,000	80	10,500	880,000	84	7,200	820,000	114	5,380	614,399	114	42.8%	36.3%	0%

ANEKSI NR. 4
RAPORTI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE TË POLITIKËS SË PROGRAMIT

Periudha e raportimit:

Kodi i programit		Emërtimi i programit:							Koment e
Qëllimi 1									
			**Treguesit e performancës/produktet:						
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit të Performancës/produktit	Emërtimi i treguesit të performancës***/produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës e	Niveli i planifikuar në vitin korrent	Niveli i rishikuar në vitin korrent	Niveli faktik në fund të vitit korrent	% e Realizimit të treguesit të performancës/Produktit	
<i>Objektivi 1.1</i>									
								#DIV/0!	
								#DIV/0!	
								#DIV/0!	
<i>Objektivi 1.2</i>									
								#DIV/0!	
								#DIV/0!	
								#DIV/0!	
<i>Objektivi 1.3</i>									

ANEKSI NR.5

PROJEKTET E INVESTIMEVE ME FINANCIM TË BRENDSHËM DHE ME FINANCIM TË HUAJ

Projektet me financim te brendshëm (në 000/lekë)

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/-vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente

Projektet me financim të huaj (në 000/lekë)

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Grant/kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti kontraktuar	Plani i buxhetit viti	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	